



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 27.09.2013
Nr. 463-1219

PËR: Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës
Hazir Raçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës

LËNDA: Shkresë ligjore

I nderuari Kryetar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), më datën 18.09.2013 ka pranuar kërkesën nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit nr. 1797, e cila ka të bëjë me kërkesën për kthimin e pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes Shoqërore "Fapol" të regjistruar si pronë komunale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të shkresës në fjalë konstaton:

- Kuvendi i Komunës nuk ka mandat ligjor për ndryshimin e emërimit të pronave të ndërmarrjeve shoqërore si dhe regjistrimin i tyre si prona komunale. Agjencia Kosovare e Privatizimit bazuar në Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka kompetencë që të administroj ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo.
- Komuna e Podujevës gjithashtu duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për kthimin e pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes Shoqërore "Fapol", nga regjistri i pronës Komunale në regjistrin e pronave të menaxhuara e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

MAPL, kërkon nga autoritetet e komunës së Podujevës të ndërmarrin veprime konkrete me qëllim të zbatimit të legjislacionit që rregullon këtë fushë

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL;
Shkelzen Lluka, Drejtor menaxhues, Agjencia Kosovare e Privatizimit;
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së;
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 27.09.2013
Br. 463-1219

Za: Agim Veliu, Gradonacelnik Opstine Podujevo
Hazir Raçi, Predsedavajuci Skupstine Opstine Podujevo

Predmet: Pravni dopis

Postovani Gradonacelnice,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave (MALS), dana 18.09.2013 je primila zahtev od Kosovske Agencije za Privatizaciju br. 1797, a koji se tice zahteva za povracaj nepokretne imovine Dustvenog Preduzeca "Fapol" registrovana kao opstinska imovina.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razamtarnja navedenog dopisa konstatuje:


- Skupstina Opstine nema zakonski mandat za izmenu imenovanja imovine drustvenih preduzeca i njihovu registraciju kao opstinska imovina. Kosovska Agencija za Privatizaciju na osnovu Zakona br. 04/L-034 o Kosovskoj Agenciji za Privatizaciju ima nadleznost da administrira preduzeca u drustvenoj svojini, nezavisno da li su podlegle transformisanju.
- Opstina Podujevo treba da preduzme potrebne mere za povracaj nepokretne imovine Drustvenog Preduzeca "Fapol", od registra opstinske imovine u registru imovine koje se menadziraju od Kosovske Agencije za Privatizaciju.

MALS, trazi od opstinskog autoriteta Opstine Podujevo da preduzme konkretne mere u cilju spovodjenja yakonodavstva koje regulise ovu oblast

S postovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera & Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a;
Shkelzen Lluka, Direktor menadzer, Kosovske Agencije za Privatizaciju;
Rukovodiocima Uprava MALS-a;
Arhivi MALS-a.



Data: 18.09.2013

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Për:

Zt. Sllobodan Petrovic,
Ministër i Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal

Lënda:

Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit lidhur me Ndërmarrjen
Shoqërore "Fapol" Podujevë.

HYRESE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data	18.09.2013		
Datum			
Date			
Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shitja	Vlera
-II-	463-1213		


Me datën 30 Janar 2012 Kuvendi Komunal i Podujevës ka marrë vendim për riemërtimin e paluajtshmerive në pronësi të Komunës. Emërtimet e paluajtshmerive të evidentuara në elaboratin kadastral: "PRONA SHOQËRORE-KUVENDI KOMUNAL" janë riemëruar si: "PRONË KOMUNALE" duke u mbështetur në bazën ligjore të nenit 12.2 pika 2 dhe nenit 18.1 pika a, të Ligjit për vetëqeverisje lokale numër 03/L-040.

Siç jeni në dijeni me ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AKP është organ dhe autoritet i pavarur publik e cila është e autorizuar të bëjë administrimin, shitjen, transferimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tyre. Prandaj konsiderojmë se ky vendim i Komunës së Podujevës është në kundërshtim të plotë me dispozitat përkatëse ligjore dhe si i tillë duhet anuluar.

NSH "Fapol" është Ndërmarrje Shoqërore e cila përbehet prej Fabrikës së gypave të polisterit dhe Terminalit Doganor. Kjo ndërmarrje është themeluar si shoqërore, prandaj tjetërsimi i saj përveç se paraqet shkelje të rëndë ligjore, tejkalim kompetencash, paraqet edhe problem i cili kalon në fushën e shkeljes së të drejtave të punëtorëve dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë ftojme Ministrinë tuaj që të obligoj Kuvendin Komunal të Podujevës të pezulloj vendimin për ndryshimin e pronësisë së Ndërmarrjes Shoqërore "Fapol", me mundësi anulimi, që do të mundësojë kthimin në gjendjen e mëparshme dhe së bashku me Agjencinë të gjejë forma tjera për zgjidhjen e këtij problemi që nuk do të jetë pengesë për zbatimin e mandatit të përcaktuar ligjor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

I nderuari Z. Ministër, duke ju falënderuar në bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm mbesim me shpresë në adresimin dhe zgjidhjen sa më të shpejtë të kësaj çështje.



Drejtor Menaxhues

DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr.
Br.
No. 0204-178/1

Data
Datum
Date 24.02.2012



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 16 Shkurt 2012
Nr. 0204-178

Për: Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës
Hazir Raçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Lënda: Shqyrtimi i ligjshmërisë së Vendimit

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar me datën 06.02.2012 vendimin e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë. Kuvendi i Komunës së Podujevës me datën 30.01.2012 ka nxjerr vendim për riemërtimin e paluajtshmerive në pronësi të komunës të evidentuar si "pronë shoqërore e kuvendit komunal më emërtim të ri pronë e komunës".

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L040, nenit 3 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226 ka konstatuar:

- Regjistrimin e pronës së paluajtshme nga ana e komunave bëhet konform emërimit të cilin e ka përcaktuar Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226.
- Të gjitha pronat e paluajtshme të cilat janë të evidentuara në regjistrat kadastral të komunës të konstatuara dhe verifikuara si pronë e komunës përdoret emërtimi i vetëm dhe unik "pronë e paluajtshme e komunës".


Andaj, MAPL-ja bazuar në të gjitha të cekurat më lartë konstaton se vendim i Kuvendit të Komunës së Podujevës është i kundërligjshëm dhe kërkon nga i njëjti organ që të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe të ndërmarr të gjitha masat dhe veprimet konkrete në mënyrë që vendimi të jetë në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović

Zëvendës-Kryeministër & Ministër i MAPL



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Pristina, 16 Februar 2012
Br. 0204-178

Za: Agim Veliu, Gradonačelnik Opštine Podujevo
Hazir Raçi, Predsedavajući Skupštine Opštine

Predmet: Razmatranje zakonitosti Odluke

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave je primilo dana 06.02.2012 odluku usvojenu od Skupštine Opštine Podujevo sa ciljem procenjivanja zakonitosti. Skupština Opštine Podujevo dana 30.01.2012 je donela odluku o preimenovanju nepokretnosti vlasništvo opštine evidentirane kao "društvena imovina skupštine opštine sa novim imenovanjem opštinska imovina".

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave na osnovu nadležnosti i zakonskog roka odredjenom u članu 81.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/ L040, članu 3 Zakona o Davanju na Korišćenje i Razmenu Opštinske Nepokretne Imovine Br. 03/L-226 je konstatovalo:

- Registracija nepokretne imovine od strane opština se vrši na osnovu imenovanja kojeg je odredio Zakon za Davanje na Korišćenje i Razmenu Opštinske Nepokretne Imovine Br. 03/L-226.
- Sva nepokretna imovina koja je evidentirana u katastarskim registrima opštine konstatovana i potvrđena kao opštinska imovina koristi se jedino i jedinstveno imenovanje sa "nepokretna opštinska imovina".

S toga, MALS na osnovu gore nevedenog konstatuje da odluka Skupštine Opštine Podujevo je protiv zakonita i traži od istog organa da razmotri navedeni akt i da preuzme sve konkretne mere da bi odluka bila u skladu sa primenjivim zakonima u Republiku Kosovo.

MALS je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć na potpunom sprovođenju ovih obaveza koje proizilaze od primenjivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović
Zamenik Premijera & Ministar MALS

A handwritten signature in dark ink, appearing to be 'S. Petrović', is written over a horizontal line.

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e
Direktorima Uprava MALS-e
Arhivi MALS-e



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d dhe 18.1 shkronja a të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 3.1 të Ligjit nr. 04/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10. Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2012, miratoi këtë:

VENDIM

PËR RIEMËRTIMIN E PALUAJTSHMËRIVE NË PRONËSI TË KOMUNËS

Neni 1

Emërtimet e paluajtshmërive të evidentuara në Elaboratin kadastral:

" Prona shoqërore – Kuvendi Komunal "

Riemërtohen:

" Pronë e Komunës "

Neni 2

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01/20-954
Podujevë,
30 janar 2012

Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi

